Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Gjemajli Bellanica;	11.05.2022	20.05.2022	*130;134/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 05/06.05.2022 OE "Graniti" sh.p.k Suharekë dhe OE "WOOD CORPORATION L.L.C" Suharekë, kanë parashtruar ankesë me nr.130/22 dhe 134/22, kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë GOE "Mobileria AGROKOS Sh.p.k & LIMANI Sh.p.k", lidhur me aktivitetit e prokurimit me titull: "Furnizim me mobile për të kthyerit dhe komunitetet në nevojë", me nr. të prokurimit: **211-22-1294-1-1-14**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria për Komunitete dhe Kthim**.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar kontratë publike kornizë me një operator ekonomik, procedurë të hapur, Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 150 000.00 €

Data e njoftimit për kontratë.....01.03.2022.
Hapja e ofertave.....11.04.2022.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së.....20.04.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....26.04.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....27.04.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE "Graniti" sh.p.k Suharekë dhe OE "ËOOD CORPORATION L.L.C" Suharekë

Dispozitat e shkelura

Neni 1 – Qëllimi
Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 28 - Specifikimet teknike
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 64 – Dëshmitë e kërkesave
Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 41 të RRUOPP
Neni 39 i RRUOPP

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet OE "Graniti" sh.p.k Suharekë

Të nderuar ne me dt. 20.04.2022 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë për **OE "MOBILERIA AGROKOS" SH.P.K. & Limani SH.P.K.**, ndërsa neve jemi shpallur si tenderues të pasuksesshëm.

Ju sqarojmë se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i **papërgjegjshëm** për faktet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk e përmbush kërkesën e FDT-së ku kërkesë ka qenë *"Operatori ekonomik duhet të ofroj katalog për mobile në bazë të specifikave të vendosura"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Katalogu duhet të përbëhet me fotografi se bashku me specifikat dhe dimenzione e tyre.(specifikat dhe dimensionet duhet të jenë sipas Aneks 1 Specifikat teknike ne dosje të tenderit) i vulosur dhe nënshkruar origjinal."*.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka prezantuar katalogun konform kërkesës së dosjes së tenderit. Kur analizohet katalogu i të njëjtit OE, kuptohet qartë se mobilet e prezantuara në katalogun e OE të rekomanduar për kontratë nuk janë të njëjta me specifikimet teknike sipas aneksit 1, për më tepër ka mobile të cilat **mungojnë në katalog**, e të cilat do ti sqarojmë më poshtë:

OE të rekomanduar për kontratë në katalogun e tij i mungon mobilja-**"Kauq klasik për dhomën e ditës",**. Pra kur analizohet katalogu i OE të rekomanduar për kontratë askund nuk figuron kauqi klasik sipas kërkesës në specifikacionin teknik të dosjes së tenderit aneksi 1. AK-ja siç duket nuk e ka analizuar në tërësi katalogun e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, pasi që nëse analizohet i njëjti, atëherë shumë lehtë dhe qartë kuptohet që i njëjti OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së si e tillë, pasi që të njëjtit siç e cekëm i mungojnë mobilet e kërkuara sipas specifikacionit teknik.
Pa pretenduar më tutje, me vetëm këtë fakt OE i rekomanduar për kontratë është dashur të eliminohet si i papërgjegjshëm.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, edhe për faktin se mobilen **Karrige për tavolin,** i njëjti nuk e ka prezantuar konform specifikacionit teknik-aneksi 1, pasi që nëse analizohet specifikacioni në DT dhe katalogu i OE të rekomanduar për kontratë, kuptohet se karriga nuk është konform kërkesës. OE i rekomanduar për kontratë për karrigen ka shkruar se është me material me bazë druri, mirëpo kur analizohet karriga e prezantuar, shihet se mbështetësja e shpinës nuk është me material druri në tërësi, mirëpo është material tjetër pra nuk është prezantuar ashtu siç është kërkuar. Gjithashtu edhe tek këmbët e karriges mungon pjesa e përparme në mes të këmbëve të karriges-**pjesa horizontale**. Në vijim po ju prezantojmë fotografinë e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë dhe fotografinë ashtu siç është kërkuar në specifikacionin teknik:

Karriga e prezantuar nga OE i rekomanduar **Karriga sipas specifikacionit teknik**

↓ ↓

Nga fotot e lartcekura, shihen qartë dallimet ndërmjet karrigave, të cilat e tregojnë qartë faktin se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka prezantuar karrigen në katalogun e tij sipas specifikacionit teknik.

Po ashtu edhe **Kuzhina,** nuk është prezantuar sipas specifikacioni teknik të DT sepse tek katalogu i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë shkruan:

Dorezat e raftave duhet te jene prej kromi Te gjitha çantat dhe sirtaret (4 sirtare) duhet te jene Soft Close..
Tavolina e punës: duhet te perbaje nje sportel te trashe 40mm me material te plastifikuar me cilësi te lartë
Përmasa e tavolines: lartesia 85cm, thellesia 60cm gjeresia 100cm (Tavolina duhet te kete dy dyer dhe kater sirtare me dimensione standarte).
Elementet te varura: lartesia 70cm thellesia 35cm gjeresia 100cm(secila familje duhet ti marre dy elemente te varura - 2m).
Lavamani: duhet te kete nje ndarje per larjen e enëve me dimensione standarte.
Raft ne pjesen e poshtme te dimensioneve te lavamanit: lartesia 85cm, thellesia 60cm, gjeresia 100cm.

Nga shënimi i lartcekur, shihet qartë se askund OE i rekomanduar për kontratë nuk e cek se dorëzat e rafteve janë prej kromi dhe çantat dhe sirtarët janë Soft Close, apo tavolina e punës përmban sportel të trashë sipas specifikacionit teknik, mirëpo në secilin përshkrim i njëjti e cek se **"duhet të jetë",** pra askund i njëjti OE nuk garanton se kuzhina është sipas specifikacionit teknik të kërkuar, mirëpo gjithmonë ceket se duhet të jetë.

Ky fakt tregon qartë se specifikat e mobileve vetëm janë përshkruar "copy paste", nga specifikacioni teknik, andaj përderisa i njëjti OE nuk e ka dëshmuar se mobiljet janë ashtu siç është kërkuar, mirëpo vetëm e cek se duhet të jenë, kjo tregon qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofertuar konform specifikacionit teknik.

Po ashtu nga fotoja e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë për kuzhinën, shihet qartë se mungon lavamani për të cili është kërkuar në specifikacion teknik që i njëjti të ketë një ndarje për larjen e enëve me dimensione standarde.

Kuzhina e prezantuar nga OE i rekomanduar ↓ Kuzhina sipas specifikacionit teknik ↓



Nga fotot e lartcekura tek kuzhina e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk figuron në

foto fare lavamani dhe ndarja e tij për larjen e enëve, andaj kjo është dëshmi e qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm. Përderisa është kërkuar katalogu origjinal me fotografi, përmes këtyre fotografive po vërtetohet se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofertuar sipas specifikacionit teknik të DT.

Shtrat multifunkcional me dyshekë- OE i rekomanduar për kontratë edhe shtratin nuk e ka ofruar konform specifikacionit teknik të DT, ku një fakt i tillë vërtetohet nga fotot e mëposhtme, ku nëse bëhen krahasimet mes shtratit të kërkuar me specifikacion teknik dhe atij të OE të rekomanduar për kontratë, vërehen dallimet shumë qartë:

Shtrati i prezantuar nga OE i rekomanduar | Shtrati sipas specifikacionit teknik

Nga fotot e lartcekura shihet qartë se pjesa e poshtme e shtratit nuk është ashtu siç ka deklaruar OE i rekomanduar për kontratë, ku i njëjti e ka shkruar se duhet të jetë me fiok dhe dysheka, mirëpo është ndryshe nga specifikacioni teknik. Këtu shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë vetëm ka kopjuar specifikat teknike nga dosja e tenderit, ku përsëri e ka shkruar se shtrati duhet të jetë dhe jo është, fakt ky që vërteton qartë se OE i rekomanduar për kontratë përveç se ka kopjuar specifikat teknike, i njëjti nuk e ka ofruar as shtratin ashtu siç është kërkuar tek specifikacioni teknik.

Dollap dykrahësh për dhomë të fjetjes-OE i rekomanduar për kontratë edhe dollapin nuk e ka ofruar konform specifikacionit teknik të DT. Ky fakt shumë lehtë kuptohet kur shikohet dollapi i mbyllur e ku tek dollapi i OE të rekomanduar për kontratë figurojnë dy fioka, e të cilat nuk janë kërkuar. Gjithashtu kur shikohet dollapi i hapur i OE të rekomanduar për kontratë vërehet se nuk është i njëjtë me dollapin siç është kërkuar në dosje të tenderit sepse është kërkuar që në pjesën e sipërme të jetë fillimisht një rafi dhe më poshtë pjesa e varëses së rrobave, kurse OE i rekomanduar për kontratë e ka të kundërtën. fillimisht pjesën e varëses së rrobave kurse raftin e ka poshtë.
Pra ka ndryshime drastike të ofertës me kërkesën e dosjes së tenderit.
Ju lutem të analizohen me kujdes këto pretendime dhe fakte.

Dollap dykrahësh për dhomë të fjetjes i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë:



Dollapi dykrahësh për dhomë të fjetjes sipas specifikacionit teknik në DT është kërkuar si më poshtë:

Dollap për dhomen e fëmijëve:
OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar këtë dollap sipas specifikacionit të kërkuar. Fillimisht në tekst shkruan se duhet të jetë nga iverpllaka etj. Nga kjo kuptohet që ky OE nuk ka garantuar se është sipas specifikimit teknik por e ka cekur se duhet të jetë.
Gjithashtu kur shikohet dollapi i hapur i OE të rekomanduar për kontratë vërehet se nuk është i njëjtë me dollapin siç është kërkuar në dosje të tenderit sepse është kërkuar që në pjesën e sipërme të jetë fillimisht një raft dhe më poshtë pjesa e varëses së rrobave, kurse OE i rekomanduar për kontratë e ka të kundërtën. fillimisht pjesën e varëses së rrobave kurse raftin e ka poshtë.

Dollapi siç është kërkuar, është si në vijim:



OE i rekomanduar për kontratë e ka ofruar dollapin si më poshtë:

Dollap per dhomen e femijeve:
Me një garderobë në mes, me rafte dhe dy sirtare.

Pasqyra në qender dollapit:

Gjersia 160 cm
Thellësia 52 cm
Lartësia 205 cm

Konstrukti I ormanit duhet te jete nga iverpllaka 18mm me dy ndarje, njera pjese duhet te jete me nje raft dhe nje varese per garderobe, ndersa pjesa tjeter duhet te jete me 4 ndarje. Ne pjesen e fundme te ormanit duhet te vendosen dy sirtare, nga nje per secilen ndarje. Garancioni nje vjecar.



OE i rekomanduar për kontratë për të gjitha produktet e ka shënuar se duhet të jetë, e në asnjë rast nuk ka garantuar dhe nuk e ka pohuar se produkti është siç e ka kërkuar autoriteti kontraktues, prandaj ky OE duhet të shpallet i papërgjegjshëm.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, për faktin se i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë *"Kerkesa 8.Operatori ekonomik duhet te ofroje deshmi se ka perfunduar me sukses furnizime te mobileve apo te ngjashme gjate 3 (tri) viteve te shkuara (duke filluar nga data e publikimit te ketij njoftimi per kontrate)"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Deshmia 8.Operatori Ekonomik duhet te ofroj nje liste te kontratave te realizuara dhe te i deshmoj me referenca. Verejtje : Kontrata /referencat private duhet te deshmohen me transaksion bankar"*.
OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e larteekur për faktin se i njëjti ka prezantuar në ofertë një listë të kontratave me kompani private, mirëpo të cilat nuk mund të vërtetohen me anë të transaksioneve bankare. Nëse analizohen transaksionet bankare të prezantuara nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë, në asnjërin prej transaksioneve nuk figuron ndonjë pagesë nga kompanitë me të cilat ka prezantuar kontratat, mirëpo figurojnë vetëm disa transfere, e të cilat nuk dihet dhe nuk mund të vërtetohet fakti se për çfarë pagesa bëhet fjalë. Pra në ato transaksione është dashur të figuroj se është bërë pagesa sipas kontratës dhe jo vetëm transaksion bankar.

Andaj përderisa një transaksion të tillë OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka prezantuar, është shumë i qartë fakti se i njëjti nuk e plotëson kërkesën e larteekur të dosjes së tenderit.

Siç duket AK-ja nuk i ka analizuar në tërësi dokumentet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë për faktin se si ka mundësi që AK-ja nuk e ka vërejtur një gjë të tillë, apo ndoshta e ka bërë qëllimisht me qëllimin e favorizimit të OE të rekomanduar për kontratë, pasi që vetëm në përgjithësi nëse analizohen transaksionet e prezantuara, kuptohet qartë se të njëjtat nuk kanë të bëjnë fare me kontratat të cilat i ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë.

Po ashtu në referencat e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë, përkatësisht tek referenca me kompaninë Anita-S SH.P.K., shkruan:

Gjatë periudhës 2019 deri me tani kemi bashkëpunuar me furnitorin e produktit të

Mobiljeve dhe kemi pasur marëdhënie te mira të punës, duke mos pasur asnjëherë vonesa

të porosive te ndryshme nga ana jone karshi biznesit ne fjalë.

Ne si biznes e ndjejmë obligim moral qe ta ndihmojmë këtë referencë si shenjë e

Nëse analizohet kjo referencë përkatësisht teksti i referencës së lëshuar nga Anita –S SH.P.K. ku shkruan duke mos pasur asnjëherë vonesa të porosive të ndryshme nga ana jonë karshi biznesit në fjalë, kuptohet që furnizim ka bërë kompania Anita-S Shpk e jo OE i rekomanduar për kontratë- **MOBILERIA AGROKOS" SH.P.K.** prandaj kjo referencë nuk është valide dhe nuk është konform kërkesave të FDT-së.

Po ashtu kjo referencë nuk duhet ti merret parasysh për faktin se në këtë referencë shkruan vetëm se kanë bashkëpunuar dhe askund nuk shkruan se ka bërë furnizime OE **MOBILERIA AGROKOS" SH.P.K.** por e kundërta. Gjithashtu në këtë referencë nuk shkruan vlera fare e furnizimeve. Po ashtu edhe në kontratën në lidhje me këtë bashkëpunim nuk shkruan askund çmimi, e i cili duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës, prandaj nga këto fakte kuptohet se edhe kontrata e edhe referenca nuk përkojnë me legjislacionin në fuqi dhe nuk plotësojnë kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Pra kjo referencë dhe kontrata e lartcekur dyshojmë që janë fiktive andaj nuk plotësojnë kërkesat e FDT-së dhe ky operator ekonomik duhet të shpallet i papërgjegjshëm.
Për më tepër, përveç këtyre dëshmive që nuk janë konform kërkesave edhe nga qarkullimi bankar nuk janë ofruar dëshmitë konkrete nga banka që tregojnë se pagesat janë bërë për këtë kontratë.
Tek qarkullimi bankar, në lidhje me kompaninë Anita-S Shpk shënon si në vijim:

30.07.2019	30.07.2019	K1903934017	TEB-ANITA S SHPK ANITA S SHPK Pagese per fat.nr. TS-SHVS1-0001 164	0.00	980.00	6,759.63

164

Nga ky transaksion nuk është e qartë se për çka ka paguar kjo kompani, prandaj nuk mund të llogaritet si valide referenca, kontrata dhe ky transaksion sepse nuk janë dëshmi konkrete se kompania **MOBILERIA AGROKOS" SH.P.K** ka furnizuar me Mobile kompaninë **Anita –S Shpk, sidomos kur kem parasysh faktin se vet kjo kompani (Anita –S Shpk) është prodhuese e mobileve, madje në ARBK shihet se është themeluar para kompanisë MOBILERIA AGROKOS" SH.P.K.**

MOBILERIA AGROKOS" SH.P.K është themeluar me dt. 22/05/2018.

Anita –S Shpk është themeluar me dt. 20/04/2017.

Prandaj është absurde dhe jashtë çdo logjike tendenca e OE të rekomanduar për kontratë për të qenë fitues me këto referenca dhe kontrata, të cilat për mendimin tonë janë fiktive, sepse nuk mund të vërtetohen objektivisht se kur janë nënshkruar kontrata në fjalë.

Gjithashtu edhe kontratat tjera dhe referencat tjera janë të një formati dhe pothuajse me tekst identik, e që për neve këto kontrata dhe referenca janë plotësisht në kundërshtim me kërkesat e FDT-së dhe dyshojmë shumë se janë fiktive.

Të gjitha kontratat tjera, me përjashtim të kontratës me GNTC Group SHA, janë kontratë bashkëpunimi dhe nuk e përmbajnë elementin kyç të kontratës-çmimin, prandaj nuk i plotësojnë kushtet për të qenë kontrata sipas ligjit për marrëdhëniet detyrimore dhe faktikisht janë të pavlefshme.

Edhe te këto kontrata dhe referenca shkruan se bashkëpunimi është bërë në fushën e prodhimit të mobileve dhe nuk dihet saktë se çfarë bashkëpunimi kanë pasur këto kompani ndërmjet veti, e po ashtu nga transaksionet nuk kuptohet se për çfarë janë bërë pagesat.

Tek qarkullimi bankar, në lidhje me kompaninë Besimi Comerce shënon si në vijim:

				Debit	Credit	Balance
20.05.2020	20.05.2020	7770047379 6	PAGESE E FATURES NR 26 SHVE 001 62 BESIMI COMMERCE SHPK	0.00	405.00	1,018.26
31.05.2020	[illegible]	[illegible]	[illegible]			

Përveç këtij transaksioni bankar ndërmjet këtyre dy kompanive të bërë me dt.20.05.2020, nuk ekziston asnjë transaksion tjetër bankar, ndërsa në referencë shkruan se që nga dt.20.05.2020 kanë pasur bashkëpunim në fushën e prodhimit të mobileve.

Në këtë rast shihet qartë tendenca për të manipuluar sepse transaksioni është bërë me dt.20.05.2020, kontrata është nënshkruar me të njëjtën datë, e po ashtu edhe në referencë shkruan që nga data 20.05.2020 ka filluar bashkëpunimi. Pra shumë lehtë në mënyrë objektive vërehet që këto kontrata dhe referenca mund të jenë fiktive dhe që mund të jenë të përpiluara më vonë, duke e ndërlidh me ndonjë transaksion të bërë për ndonjë shërbim apo diçka tjetër. Këto pretendime tonë ka mundur ti vërtetojë AK-ja, mirëpo mund të vërtetohen edhe tani.

Tek qarkullimi bankar, në lidhje me kompaninë Nica Swiss Group Shpk shënon si në vijim:

30/12/2021	Transfer from NICA SWISS GROUP SHPK	EUR	0.00	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]

Edhe në këtë rast, kontrata dhe referenca janë pothuajse identike si të tjerat dhe normalisht nuk mund të merren parasysh dhe valide.

Tek qarkullimi bankar, në lidhje me kompaninë GNTC Group SHA shënon si në vijim:

19/03/2021	19/03/2021	Transfer from GNTC GROUP SHA	EUR	EUR	1.730,00	1.766,02	6440
06/04/2021	06/04/2021	Transfer from GNTC GROUP SHA	EUR		0,00	15.000,00	15.186,58	9023

Në lidhje me kontratën e lidhur ndërmjet anëtarit të konzorciumit Limani Shpk me GNTC Group SHA, ka kundërthënie të mëdha ndërmjet kontratës, referencës dhe transaksioneve bankare. Në kontratë titulli i kontratës është "Furnizim me mobile dhe interier dhe kryerja e punëve që janë të nevojshme për departament stores, me vlerë të kontratë prej 150, 000.00 euro e lidhur me dt.18.03.2018, ndërsa referenca e ka titullin "Furnizimi me rafte dhe dollapa per ekspozitë, te gjitha sipas porosise."

Dhe shkruan se Limani Shpk ka qenë bashkëpunëtor gjatë viteve 2019, 2020,2021.
Kontrata është e lidhur me dt.18.03.2018, ndërsa referenca shkruan se bashkëpunimi ka qenë gjatë viteve 2019, 2020, 2021. Në këtë rast kuptohet që kontrata dhe referenca mund të jenë fiktive, ndërsa referenca është lëshuar për tri vite, kuptohet me qëllim që të përfshijë qarkullimin dhe kryerjen e punëve gjatë tri viteve të fundit për tu plotësuar kërkesa e FDT-së.
Kontrata ka qenë e lidhur në vlerë 150 mijë euro, kurse transaksione ndërmjet këtyre dy kompanive ka një në vlerë 15,000.00 euro, dhe tjetra në vlerë prej 1,700.00 euro, vlera këto që nuk përputhen me vlerën e kontratës së nënshkruar, prandaj edhe kjo kontratë dhe referencë nuk mund të konsiderohet e vlefshme.

Autoriteti kontraktues në këtë tender ka përdor standarde të dyfishta, sepse një operator ekonomik "Wood Corporation LLC" e ka eliminuar për arsye se i ka marr fotot nga dosja e tenderit, ndërsa OE e rekomanduar për kontratë e ka shpall të përgjegjshëm dhe e ka rekomanduar për kontratë edhe pse i njëjti përshkrimin e ka marr nga dosja e tenderit dhe po ashtu nuk ka ofruar as katalog siç është kërkuar, por ka ofruar kopje të specifikimeve teknike.

Ne pajtohemi me arsyet e AK-së për eliminimin e OE **WOOD CORPORATION LLC**, pasi që i njëjti është i papërgjegjshëm, ashtu siç e ka konstatuar edhe vet AK-ja.

Ne me dt. 27.04.2022 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin për kërkesën për rishqyrtim ku AK-ja e ka refuzuar me arsyetimin si e pa bazuar.
AK-ja është arsyetuar si ne vijim:

Ne lidhje me arsyetimin e AK-së se OE i rekomanduar për kontratë, pas kërkesës për sqarime shtesë e ka ofruar artikullin e munguar, ky arsyetim është i pa qëndrueshëm dhe pa bazuar ne ndonjë fakt konkret sepse askund në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë nuk figurojnë specifikat e produktit nr.1 Kauq Klasik për dhomën e ditës. Vet AK-ja në vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim e cek se të njëjtit i mungon produkti i lartcekur, andaj përderisa specifikat e produktit të lartcekur nuk figurojnë askund, as tek deklarata mbi specifikimet teknike e as në katalog. Pra për tu kërkuar sqarime shtesë duhet të ofrohen specifikat e të njëjtit, mirëpo përderisa specifikat e tilla nuk figurojnë tek oferta e OE të rekomanduar për kontratë, atëherë është i qartë fakti se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së.

AK-ja me arsyetimin e lartcekur edhe një herë po e vërteton faktin se në këtë aktivitet të prokurimit, po favorizohet haptas OE i rekomanduar për kontratë edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm dhe njëkohësisht po diskriminohemi ne si OE i përgjegjshëm dhe OE që është dashur të rekomandohemi për kontratë.

Sa i përket arsyetimit tjetër të AK-së ku e njëjta e ka cekur se :

Ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar dhe nuk përkon me pretendimet tona ankimore.

Ne po e sqarojmë edhe njëherë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar kontrata te rregullta si dhe disa transaksione bankare qe i ka ofruara, po te njëjtat nuk përputhen me vet ato kontrata që i ka ofruar si dëshmi ne ofertën e saj.

Ne mungesë te dëshmive konkrete AK-ja nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore ku e kemi sqaruar dhe dëshmuar me fakte se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar kontrata te rregullta ashtu siç parashihen me ligjin për marrëdhëniet detyrimore dhe po ashtu edhe transaksionet bankare nuk përmbajnë asnjë sqarim se për cilin projekt konkret është kryer pagesa.

Në lidhje me kontratat e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë ne kemi parashtruar pretendimet tona dhe njëkohësisht dyshimet se kontratat e prezantuara janë fiktive, pasi që kur analizohen në tërësi kontratat e tilla, shihen qartë mospërputhjet në vlerat e kontratës dhe transaksioneve të bëra. Po ashtu nga njëra kontratë shihet qartë fakti se dyshimet se kontrata e tillë është fiktive janë të bazuara përkatësisht kontrata me Besimi Commerc, pasi që në këtë rast shihet qartë tendenca për të manipuluar sepse transaksioni është bërë me dt.20.05.2020, kontrata është nënshkruar me të njëjtën datë, e po ashtu edhe në referencë shkruan që nga data 20.05.2020 ka filluar bashkëpunimi.

AK-ja nuk është marr fare me dyshimet tona dhe nuk i ka vërtetuar apo dëshmuar të kundërtën e tyre, mirëpo për më tepër vetëm sa i ka shtuar edhe më shumë dyshimet tona, se kontratat e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë janë fiktive. AK-ja edhe në këtë rast po e shfaq hapur favorizimin që po i bën OE të rekomanduar për kontratë, pasi që të gjitha faktet dhe dëshmitë e prezantuara nga ana jonë e tregojnë qartë faktin se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm vërtetohet nga fakti se AK-ja nuk i ka analizuar në tërësi pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë.
Nga vendimi i AK-së ku e njëjta nuk i ka shqyrtuar në tërësi pretendimet tona ankimore vërtetohet edhe një herë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, pasi që nëse OE i rekomanduar për kontratë do ti plotësonte të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe nëse eventualisht produktet e ofruara nga i njëjti në katalog do të ishin konform specifikave teknike, atëherë edhe AK-ja do ti refuzonte pretendimet tona ankimore me fakte dhe dëshmi konkrete, mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë pasi që nuk është marr fare me pretendimet tona ankimore, dhe ky veprim i AK-së tregon qartë një anshmërinë/favorizimin e AK-së kundrejt OE të rekomanduar për kontratë dhe diskriminimin që AK-ja po na bën neve si OE i përgjegjshëm.

Ne e kemi cekur edhe në kërkesë për rishqyrtim se AK-ja në këtë aktivitet të prokurimit ka përdorur standarde të dyfishta pasi që një operator ekonomik "Wood Corporation LLC" e ka eliminuar për arsye se i ka marr fotot nga dosja e tenderit, ndërsa OE e rekomanduar për kontratë e ka shpall të përgjegjshëm dhe e ka rekomanduar për kontratë edhe pse i njëjti përshkrimin e ka marr nga dosja e tenderit dhe po ashtu nuk ka ofruar as katalog siç është kërkuar, por ka ofruar kopje të specifikimeve teknike, mirëpo edhe ky pretendim i yni nuk është shqyrtuar, pasi që i njëjti e vërteton fakti se në këtë aktivitet të prokurimit po favorizohet vetëm një OE i cili është OE i rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura, kuptohet qartë e vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, po ashtu i pa mbështetur në dispozita ligjore dhe fakte konkrete, mirëpo është vetëm një arsyetim me të cilin AK-ja po mundohet me çdo kusht të i mbuloj të metat e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, pasi që i njëjti është i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese ahe do të veproj ë në mënyrë transparente.* Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që **Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"**, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj Ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"GRANITI SH.P.K "**.
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERSIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet OE "ËOOD CORPORATION L.L.C" Suharekë

I. KRONOLOGJIA E FAKTEVE

1.1. Autoriteti Kontraktues me datë 02.03.2022 ka bërë publikimin e Njoftimit për Kontratë në Platformën e e-Prokurimit me të cilën ka kërkuar oferta për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me mobile për të kthyerit dhe komunitetet në nevojë" dhe me numër të Prokurimit: 211-22-1294-1-1-1.

1.2. Vlera e parashikuar e kontratës sipas Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Kontratë ishte 150,000.00 Euro.

1.3. Me datë 14.03.2022 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

1.4. Brenda afatit ligjor operatori ekonomik Wood Coorporation LLC (tutje referuar si Ankuesi) ka dorëzuar ofertën për këtë aktivitet të prokurimit, duke i plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

1.5. Me datë 11.04.2022 është bërë hapja e ofertave financiare dhe leximi i çmimeve, e që oferta e operatorit ankues sipas procesverbalit të hapjes së ofertave ishte oferta më e lirë prej 128,460.00 Euro.

1.6. Me datën 20.04.2022 Autoriteti kontraktues ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, me anë të së cilës jemi njoftuar se oferta jonë është vlerësuar si e papërgjegjshme, kinse për shkak se katalogu nuk ishte në përputhje me dosjen e tenderit dhe ndër të tjera janë përmendur edhe arsye si kopjim i fotografive dhe mungesa e informatave për materialet që do të përdoren në produkte dhe të tjera.

1.7. Operatori ekonomik ankues menjëherë ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare dhe ka mësuar se vlerësimi i ofertave nuk ishte bërë në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik dhe parimet e tij, për shkak se Autoriteti Kontraktues kishte përdorur standarde të dyfishta në vlerësim. Përderisa oferta e operatorit ankues ishte vlerësuar me qëllim të eliminimit, duke u theksuar arsye të paqëndrueshme të eliminimit të cilat është dashur të eliminohen përmes kërkesave për sqarime të tenderit, ndërsa tek operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka të meta të cilat do të duhej ta shpallnin të njëjtin të papërgjegjshëm, por që nuk janë vërejtur fare nga Autoriteti Kontraktues.

1.8. Brenda afatit ligjor është paraqitur kërkesa për rishqyrtim me datë 25.04.2022, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka nxjerr vendim mbi "Hudhjen Poshtë" të Kërkesës për Rishqyrtim me datë 27.04.2022.

II. BAZA LIGJORE

2.1. Ligji për Prokurimin Publik ka përcaktuar në Nenin 7 [Parimin e Barazisë në trajtim dhe mos diskriminimin] në të cilin thuhet: "*1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik[...]Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.*"

2.2. Për më tepër tek Neni 28 i Ligjit [Specifikimet teknike] thuhet: *"[...]Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik[...]"*

2.3. Çështja kontestuese në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ankues rregullohet me Nenin 72 [Dokumentacioni dhe informacioni shtesë] ku thuhet: *"Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive."*

2.4. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik tek Neni 39 [Sqarimi i Tenderëve] edhe më tutje e sqaron këtë çështje ku thuhet: "*Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtese në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomikë dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, certifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesat kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve ne pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtese të paraqitura.*"

III. AUTORITETI KONTRAKTUES KA SHKELUR LIGJIN NË VLERËSIMIN E OFERTAVE

Oferta e Operatorit Ankues është vlerësuar në kundërshtim të hapur me Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e tjera në fuqi. Pasi që e njëjta ishte oferta me çmimin më të lirë Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar atë duke përdorur standarde të dyfishta të vlerësimit për arsyet që do të sqarohen në vazhdim:

3.1. Autoriteti Kontraktues në Njoftimin për vendimin e AK ka cekur këto arsye për eliminimin e ofertës së Ankuesit e cila ishte oferta më e lirë në këtë tender: "*Gjatë vlerësimit komisioni ka konstatuar se ju nuk keni dorëzuar katalogun të juajin por që i keni marrur fotografitë nga dosja e tenderit dhe i keni prezantuar si katalog. Është dashur që ju të ofroni katalogun e juajin së bashku me foto të modeleve tuaja.*" Për më tepër në të njëjtin arsyetim Autoriteti Kontraktues ka thënë se në disa artikuj nuk janë cekur qartë materialet që do të përdorën në këto produkte.

3.2. Përderisa kërkesa e dosjes së tenderit në lidhje me katalogun ishte: "*Kërkesa 12. Operatori ekonomik duhet të ofroj katalog për mobile në bazë të specifikave të vendosura - Dëshmia 12. Katalogu duhet të përbëhet me fotografi së bashku me specifikat dhe dimenzione e tyre.(specifikat dhe dimenzionet duhet të jenë sipas Aneks1 Specifikat teknike ne dosje të tenderit) i vulosur dhe nenshkruar origjinal.*"

3.3. Në rastin konkret askund nuk ka qenë e ndaluar që ne si operator ekonomik të mos i përdorim fotografitë e Dosjes së Tenderit, përkundrazi në këtë mënyrë ne kemi theksuar se marrim përsipër që në mënyrë identike të prodhojmë produktet e kërkuara nga ana jonë 100 përqind sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Po të kishim bërë ne çfarëdo modifikimi të produktit, kjo do të mund të përdorej si arsye për eliminimin e ofertë tanë.

3.4. Se ky katalog ishte në rregull e dëshmon më së miri fakti i krahasimit të

katalogun tonë me operatorin tjetër Graniti ShPK, i cili ka ofruar një katalog krejt në kundërshtim me dosjen e tenderit dhe pa asnjë specifikë, dhe komisioni vlerësues i ofertave e ka konstatuar se oferta ishte e përgjegjshme. Edhe pse kjo ofertë nuk është shpallur fituese pasi nuk kishte çmimin më të lirë, kjo dëshmon se Autoriteti Kontraktues në mënyrë diskriminuese ka bërë vlerësimin e Ankuesit në këtë aktivitet të prokurimit.

3.5. Të gjitha informacionet e nevojshme që Autoriteti Kontraktues i ka cekur në Njoftimin e vendimit të AK-së do të mund të i kishte kërkuar si informacione sqaruese të tenderit siç rregullohet në nenin 72 të Ligjit të Prokurimit Publik dhe Neni 39 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

3.6. Mos kërkimi i sqarimeve e dëshmon se Autoriteti Kontraktues nuk ishte i paanshëm apo profesional në vlerësimin e ofertave dhe në këtë mënyrë ka diskriminuar ofertën më të lirë, ku përveç dëmtimit të operatorit ankues ka dëmtuar edhe vet buxhetin publik.

IV. OPERATORI I REKOMANDUAR PËR KONTRATË DO TË DUHEJ TË VLERËSOHEJ I PAPËRGJEGJSHËM

4.1. Oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënien e kontratës ka shumë mangësi dhe si e tillë është dashur të vlerësohej si e papërgjegjshme. Në këtë ofertë katalogu i operatorit ekonomik nuk ka asnjë përshkrim, fotografi dhe fare nuk e përfshin kolltukun apo produktin nr. 1 sipas Dosjes së Tenderit. AK pretendon se këto mungesa janë rregulluar me kërkesa për sqarime, por kjo nëse është e vërtetë do të përbënte shkelje materiale të rregullave të prokurimit pasi që oferta do të plotësohej pas dorëzimit me të dhëna të cilat nuk janë të verifikueshme dhe në kundërshtim me RrUOPP.

4.2. Në dosje ky produkt është kërkuar me këto karakteristika 'Kauq klasik për dhomën e ditës - (multifunksional për uljen dhe fjetjen) me gërshërë dhe mbulesë rezistente, dimension 100cm x 200cm (e mbyllur) zona e fjetjes 195cm x 120cm, me sistemin e hapjes A43 me gërshërë dhe susta dyshe, pjesa e pasme me mbrojtje të dyfishte/ nje vit garanci.'

4.3. Meqë oferta dhe katalogu i operatorit të rekomanduar për kontratë fare nuk e përmban këtë artikull e njëjta ofertë është në shpërputhje materiale me kërkesat e dosjes së tenderit dhe si e tillë nuk mund të shpërblehet me kontratë. Autoriteti kontraktues duke i mbyllur sytë pranë këtij lëshimi material ka bërë shkelje flagrante të rregullave të prokurimit publik dhe dosjes së tenderit, pasi që oferta qartazi nuk është në përputhje me specifikacionet teknike të tenderit.

4.4. Po ashtu shumë produkte të operatorit të rekomanduar për dhënie të kontratës nuk janë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket karakteristikave teknike të produktit dhe atyre funksionale.

4.5. Referencat dhe kontratat e operatorit ekonomik të cilat janë dorëzuar nuk përmbajnë faturat dhe si të tilla nuk mund të dëshmohen se janë zbatuar në përputhje me atë çfarë deklarohet në kontratë apo referencë. Autoriteti kontraktues i ka falur besimin me sy të mbyllur përderisa nuk ka kërkuar asnjë sqarim sa janë zbatuar këto kontrata dhe për ti krahasuar të njëjtat me transaksionet bankare bazuar në fatura të lëshuara.

Andaj, duke u bazuar në të gjitha ato çfarë u thanë më lartë i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që të nxjerr këtë vendim:

I. APROVOHET, si plotësisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik Wood Corporation L.L.C. me seli në Suharekë të cilin sipas Autorizimit e Përfaqëson Avokat Isuf Zejna, në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me mobile për të kthyerit dhe komunitetet në nevojë" me numër të prokurimit 211-22-1294-1-1-1 i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria për Komunitete dhe Kthim.

II. DETYROHET, Autoriteti Kontraktues që brenda periudhës prej 10 ditësh të bëjë rivlerësimin e ofertave në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me mobile për të kthyerit dhe komunitetet në nevojë" me numër të prokurimit 211-22-1294-1-1-1 i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria për Komunitete dhe Kthim në përputhje me këtë vendim.

III. I KTHEHET TARIFA E ANKESËS, operatorit ekonomik ankues Wood Corporation pasi që ankesa është aprovuar si e bazuar.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

Kërkesa 4.Certifikata e regjistrimit të biznesit e lëshuar nga MTI, ose regjistrimin e biznesit nga vendi i themelimit të ofertuesit (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë)
Kërkesa 5.Certifikata e regjistrimit të TVSH-së
Kërkesa 6.Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Kërkesa 7.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se qarkullimi financiar për tri vitet e fundit ka qenë minimumi 200,000.00 €.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 8.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të mobileve apo të ngjashme gjatë 3 (tri) viteve të shkuara (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë).
Kërkesa 9.Operatori ekonomik duhet të ofroj garancion për furnizimet e kryera.
Kërkesa 10.Operatori ekonomik duhet të ketë së paku një(1) kamion apo kombi për transportin e mallrave.
Kërkesa 11.Liferimi i furnizimeve është 7 ditë nga data e marrjes së porosisë.
Kërkesa 12. Operatori ekonomik duhet të ofroj katalog për mobile në bazë të specifikave të vendosura.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

Dëshmia 4.Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje)
Dëshmia 5.Certifikata e regjistrimit të TVSH-së (Kopje)
Dëshmia 6.Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal (kopje)

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Deshmia7.Raportinmbiqarkulliminfinanciarngandonjebankelicencuar në Kosovë.

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Dëshmia8.Operatori Ekonomikduhettëofrojnjëlistëtëkontratavetërealizuaradhetëideshmojmereferenca.
Vërejtje:Kontrata/referencat private duhet të dëshmohen me transaksion bankar.
Dëshmia9.OE duhet të ofrojnjë deklaratë me shkrim të vulosur dhe të nënshkruar se ofron garancion prej një (1) viti për mobile.

Dëshmia10.Operatori Ekonomik duhet të sjell librezën e qarkullimit të kamionit apo të kombit kopje në emër të kompanisë ose pronarit të kompanisë ose te ketë marrëveshje të noterizuar me ndonjë individ - kompani i cila posedon kamiona te cilit i merr në shfrytëzim

Dëshmia11.Një deklaratë me shkrim e vulosur dhe e nënshkruar se afati i liferimit te furnizimeve duhet te jetë
max 7 ditë.

Dëshmia12.Katalogu duhet të përbëhet me fotografi së bashku me specifikat dhe dimensione e tyre.(specifikat dhe dimensionet duhet të jenë sipas Aneks1 Specifikat teknike ne dosje të tenderit) i vulosur dhe nënshkruar origjinal.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Ministria për Komunitete dhe Kthim shpërblen me kontratë GR OE: MOBILERIA AGROKOS SHPK & LIMANI SHPK në vlerë totale prej: 138,934.00 €.

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "Graniti" sh.p.k Suharekë dhe OE "WOOD CORPORATION L.L.C" Suharekë

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "Graniti" sh.p.k Suharekë

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk ka arritur t'i përmbush kërkesat e FDT-së. OE i propozuar për kontratë nuk ka prezantuar katalogun konform kërkesës së dosjes së tenderit. Kur të analizohet katalogu i të njëjtit OE kuptohet qartë se mobiliet e prezantuara në katalogun e OE të rekomanduar për kontratë nuk janë të njëjta me specifikimet teknike sipas aneksit 1, për më tepër ka mobile të cilat mungojnë në katalog.

OE të rekomanduar për kontratë në katalogun e tij i mungon mobilja "Kauq klasik për dhomën e ditës". AK-ja siç duket nuk e ka analizuar në tërsi katalogun e OE të propozuar për kontratë pasi që nëse analizohet i njëjti, atherë shumë lehtë dhe qartë kuptohet që i njëjti OE është i pa përgjegjshëm dhe është dashur të konsiderohet si i tillë edhe nga ana e AK-së.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Operatori ekonomik duhet të ofroj katalog për mobile në bazë të specifikave të vendosura*"
Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Katalogu duhet të përbëhet me fotografi së bashku me specifikat dhe dimensione e tyre.(specifikat dhe dimensionet duhet të jenë sipas Aneks1 Specifikat teknike ne dosje të tenderit) i vulosur dhe nënshkruar origjinal*".

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar dokumentet e ofruar në E prokurim , për këtë aktivitet të prokurimit sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar katalogun i cili është kërkuar në FDT, mirëpo në katalogun e ofruar mungon produkti apo artikulli 1 " Kauq klasik për dhomën e ditës". AK-ja duke u mbështetur në nenin 39 të RRUOPP-së dhe nenit 69 të LPP-së i ka kërkuar sqarime OE të rekomanduar për kontratë lidhur me mungesën e këtij artikulli dhe me dt. 27.04.2022 OE i rekomanduar për kontratë i përgjigjet AK-së duke ia bashkangjitur fotografin së bashku me specifikat teknike për artikullin 1.
Nga përgjigjja e dhënë nga OE i rekomanduar për kontratë shihet që specifikat teknike janë të përshkruara sikurse në aneksin 1 të FDT-së, mirëpo fotografia e "Kauqit klasik për dhomën e ditës" i mungon pjesa e pasme me mbrojtje të dyfishte. Në vijim po u bashkëngjisim fotot se bashku me specifikimet teknike te kërkuara ne Aneksin 1 të FDT-së.

- **Kauq klasik për dhomën e ditës**

- për dhomën e ndenjes
(multifunksional për uljen dhe fjetjen) me gërshërë dhe mbulesë rezistente,
dimension 100cm x 200cm (e mbyllur)
zona e fjetjes 195cm x 120cm, me sistemin e hapjes A43 me gërshërë dhe susta dyshe, **pjesa e pasme me mbrojtje të dyfishte**/ nje vit garanci.

Ndërsa në vijim po u bashkëngjisim specifikat teknike te artikullit 1 si dhe fotografit e artikullit të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë në përgjigjen e dhënë për AK-në.

- **Kauq klasik për dhomën e ditës**

- për dhomën e ndenjes
(multifunksional për uljen dhe fjetjen) me gërshërë dhe mbulesë rezistente,
dimension 100cm x 200cm (e mbyllur)
zona e fjetjes 195cm x 120cm, me sistemin e hapjes A43 me gërshërë dhe susta dyshe, pjesa e pasme me mbrojtje të dyfishte/ nje vit garanci.





Nga fotografia e ofruar kuptojmë që OE i rekomanduar për kontratë artikullin 1 Kauq klasik për dhomën e ditës të cilin e ka ofruar nga pjesa e pasme pa mbrojtje të dyfishtë ndërsa kërkesë e aneksit 1 të FDT-së është: "pjesa e pasme me mbrojtje të dyfishtë", andaj eksperti shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar artikullin 1 sipas kërkesës së aneksit 1 të dosjes së tenderit. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues thotë se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm, edhe për faktin se mobilen "Karrige për tavolinë", i njëjti nuk e ka prezantuar konfrorm specifikacionit teknik-aneksi 1.pasi nëse analizohet specifikacioni në DT dhe katalogu i OE të rekomanduar për kontratë, kuptohet se karriga nuk është konformë kërkesës. OE i rekomanduar për kontratë për karrige ka shkruar se është me material me bazë druri në tersi, mirëpo është material tjetër pra nuk është prezantuar ashtu siç është kërkuar. Gjithashtu edhe tek këmba e karriges mungon pjesa e përparme në mes të këmbëve të karriges-pjesa horizontale.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e Aneksit 1 të FDT-së lidhur me artikullin karrige për tavolinë është:

Karrige për tavolin

Dimenzionet:

Gjerësia e ulsës: 45 cm,

Gjatësia e ulsës: 45 cm,
Lartësia e karriges: 80 cm.
Lartësia e ulëses: 45 cm.

Për plotësimin e kësaj kërkese të aneksit 1 të FDT-së, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar artikullin me specifika teknike dhe me fotografi si në vijim:

Karrige për tavolin
-(Minimum 4 karriga për familje, mbi 4 antarë nga një për secilin antarë të familjes), me material me bazë druri.
Përmasat:
Gjersia ulsës: 45cm
Gjatësia e ulsës: 45cm
Lartësia e karriges: 80cm
Lartësia e ulëses: 45cm
Garancion një vjeqar.

Nga dëshmitë e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë shihet se përshkrimin e specifikave teknike, OE e ka cekur me material me bazë druri ndërsa në fotografi shihet që karriga e ofruar është në të dy pjesët e njëjtë sikurse ulësja e karriges dhe pjesa e mbështetjes së shpinës, ndërsa në aneksin 1 të FDT-së, pjesa e mbështetjes së shpinës është me material druri. Gjithashtu i mungon edhe pjesa e përparme në mes të këmbëve tek pjesa horizontale e karriges. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar për faktin se karriga nuk është ofruar ashtu siç është kërkuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues thotë se edhe Kuzhina nuk është prezantuar sipas specifikacionit teknik të DT-së. Nga shënimet shihet qartë se askund OE i rekomanduar për kontratë nuk e cek se dorezat e rafteve janë prej kromi dhe çantat dhe sirtarët janë "Soft Close", apo tavolina e punës përmban sportel të trashë sipas specifikacionit teknik, mirëpo në secilin përshkrim i njëjti cek se "duhet të jetë", pra askund i njëjti OE nuk garanton se kuzhina është sipas specifikacionit teknik të kërkuar, mirëpo gjithmonë cek se duhet të jetë. Ky fakt tregon se specifikacionet e mobileve vetëm janë përshkruar "copy paste" nga specifikacioni teknik, andaj për deri sa i njëjti OE nuk e ka

dëshmuar se mobilet janë ashtu siç është kërkuar, mirëpo vetëm e cek se duhet të jenë, kjo tregon qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm sepse nuk ka ofertuar konform specifikacionit teknik.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e aneksit 1 të FDT-së është:

•Kuzhina

Dimenzionet:

Bërja e rafteve me material kompensatë 18mm me 1mm ABS.
Dera e bërë nga mediapan 18mm me ABS 1mm.
Pjesa e pasme e rafteve me material kompensatë 3 mm.
Dorezat e rafteve duhet të jenë prej kromi. të gjitha çantat dhe sirtarët (4 sirtarë) duhet të jenë Soft Close.
Tavolina e punës: duhet të përmbajë një sportel të trashë 40 mm me material të plastifikuar me cilësi të lartë.
Përmasat e tavolinës: lartësia 85 cm, thellësia 60 cm, gjerësia 100 cm (Tavolina duhet të ketë dy dyer dhe katër sirtarë me dimensione standarde).
Elemente të varura: lartësia 70 cm, thellësia 35 cm, gjerësia 100 cm (secila familje duhet të marrë dy elementë të varur = 2 m).
Lavaman: duhet të ketë një ndarje për larjen e enëve me dimensione standarde.
Raft në pjesën e poshtme të dimensioneve të lavamanit: lartësia 85 cm, thellësia 60 cm, gjerësia 100 cm.
Një vit garancion.

Ndërsa OE i propozuar për kontratë ka ofruar artikullin si në vijim:

Kuzhina
Dimenzionet:
Bërja e raftave me material kompensatë 18mm me 1mm ABS
Dera e bërë nga mediapan 18mm me ABS 1mm
Pjesa e pasme e raftave me material kompensatë 3mm
Dorezat e raftave duhet te jenë prej kromi.Të gjitha çantat dhe sirtarët (4 sirtarë) duhet të jenë Soft Close.
Tavolina e punës: duhet të përbajë një sportel të trashë 40mm me material të plastifikuar me cilësi të lartë
Përmasa e tavolinës: lartësia 85cm, thellësia 60cm gjerësia 100cm (Tavolina duhet të ketë dy dyer dhe katër sirtarë me dimensione standarte).
Elementet të varura: lartësia 70cm thellësia 35cm gjerësia 100cm(secila familje duhet ti marrë dy elementë të varura =2m).
Lavamani: duhet të ketë një ndarje për larjen e enëve me dimensione standarte.
Raft në pjesën e poshtme të dimensioneve të lavamanit: lartësia 85cm, thellësia 60cm, gjerësia 100cm.
Një vit garancion.

Nga prezantimi i dëshmisë së ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë kuptohet se specifikat teknike janë përshkruar ashtu siç janë në aneksin 1 të FDT-së, për faktin se OE ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka saktësuar që kuzhina është sipas specifikacionit teknik të kërkuar në aneksin 1. Gjithashtu në fotografin e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë mungon Lavamani ku sipas specifikimeve teknike të aneksit 1 duhet të përfshihej ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka përshkruar specifikimin teknik por nuk ka prezantuar në fotografi Lavamanin. Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE i rekomanduar për kontratë edhe shtrat multifunksional me dyshek nuk e ka ofruar konform specifikacionit teknik të DT-së, ku i një fakt i tillë vërtetohet në fotot. Nëse bëhet krahasimi në mes të shtratit të kërkuar me specifikacionin teknik dhe atij të OE të rekomanduar për kontratë, vërehet dallimet shumë të qarta. Nga fotot shihet qartë se pjesa e poshtme e shtratit nuk është ashtu siç ka deklaruar OE i rekomanduar për kontratë, ku i

njëjti e ka shkruar se duhet të jetë me fiok dhe dysheka, mirëpo është ndryshe nga specifikacioni teknik. Këtu shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë vetëm ka kopjuar specifikat teknike nga dosja e tenderit , ku përsëri e ka shkruar se shtrati duhet të jetë dhe jo është, ky fakt vërteton qartë se OE i rekomanduar për kontratë përveç se ka kopjuar specifikat teknike, i njëjti nuk e ka ofruar as shtratin ashtu siç është kërkuar tek specifikacioni teknik.

Për këtë artikull në Aneksin 1 të FDT-së është kërkuar:

Shtrat multifunkcional me dyshekë
e ngritur - 90x200cm
+ krevat sirtari 90x190cm
Lartësia e kokës 160 cm,
Lartësia e kokës së vetme 80cm.

Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar artikullin Shtrat multifunksional në këtë formë:

Shtrat multifunkcional me dyshekë

Kreveti dysh (me shkallë) për femijë me dyshek: lartësia 90x200 cm + sirtari 90x190cm Lartësia e mbështetsës së kokës 160 cm Lartësia e mbështetsës së kokës single 80 cm.

Garancion nje mbështetsës së kokës vjeqar.

Vërejtje: Çmimi për krevat duhet të jetë për copë (për 1 person me këto dimensione), nëse I kërkojm dy shtrata për nje familje duhet të jetë shtrati ne kat me mekanizem qe ne të ardhmen mund te perdoren edhe veçmas nese I kerkojm tre shtrata per nje familje duhet të jene si ne katallog me fijok dhe me dysheka

Nga dëshmia e ofruar kuptojmë që OE i rekomanduar për kontratë specifikat teknike janë ofruar ashtu siç janë kërkuar në aneksin 1 të FDT-së, mirëpo nga fotografia kuptohet se pjesa fundore e shtratit në aneksin 1 të FDT-së është kërkuar të jetë lëvizëse ndërsa nga dëshmia e OE të rekomanduar për kontratë kuptohet që pjesa fundore e shtratit është statike. Andaj eksperti shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë artikullin Shtrat multifunksional me dyshek nuk e ka ofruar ashtu siç është kërkuar në aneksin 1 të FDT-së, ndaj dhe pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 5

OE i rekomanduar për kontratë edhe dollap dykrahësh për dhomë të fjetjes nuk e ka ofruar konform specifikacionit teknik të DT-së. Ky fakt shumë ehtë kuptohet kur shikohet dollapi i mbyllur, e ku tek dollapi i OE të rekomanduar për kontratë figurojnë dy fioka e të cilat nuk janë kërkuar. Gjithashtu kur shikohet dollapi

i hapur i OE të rekomanduar për kontratë vërehet se nuk është i njëjtë me dollapin siç është kërkuar në dosje të tenderit sepse është kërkuar që në pjesën e sipërme të jetë fillimisht një raft e më poshtë pjesa varëses së rrobave. Kurse OE i rekomanduar për kontratë e ka të kundërtën, fillimisht pjesën e varëses së rrobave kurse raftin e ka poshtë. Pra ka ndryshime drastike të ofertës me kërkesën e dosjes së tenderit.

Në aneksin 1 të FDT-së është kërkuar artikulli Dollap dy krahësh për dhomë të fjetjes me specifika teknike dhe me foto si në vijim:

- **Dollap dykrahësh për dhomë të fjetjes:**

Gjerësia 120 cm
Thellësia 52 cm
Lartësia 205 cm



Ndërsa OE i propozuar për kontratë ka ofruar artikullin si në vijim:

Dollap dykrahësh për dhomë të fjetjes:

Gjersia 120 cm
Thellësia 52 cm
Lartësia 205 cm

Konstrukti I ormanit duhet të jetë nga iverpllaka 18mm me dy ndarje, njëra pjesë duhet të jetë me një raft dhe një varse për garderobë, ndërsa pjesa tjeter duhet të jetë me 4. Dyert duhet te jenë nga mediapani i plastifikuar 18mm. Garancion një vjeqar

Nga dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë kuptojmë që Dollapi dy krahësh për dhomë të fjetjes nuk është ofruar sipas kërkesës së dosjes së tenderit për faktin se nga pjesa e jashtme kuptohet që dollapi i prezantuar nga OE i propozuar për kontratë ka dy fioka të cilën nuk janë kërkuar nga AK-ja, ndërsa kur shikohet pjesa e brendshme e dollapit kuptohet që pjesa e sipërme është kërkuar të jetë me një raft ndërsa pjesa tjetër varësja për rroba, ndërsa OE i propozuar për kontratë nuk e ka ofruar artikullin Dollap dykrahësh për dhomën e fjetjes ashtu siç është kërkuar në Aneksin 1 të FDT-së. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 6

OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar dollap për dhomën e fëmijëve sipas specifikacionit teknik të kërkuar. Fillimisht në tekst shkruan se duhet të jetë nga Iverpllaka etj. Nga kjo kuptohet që ky OE nuk ka garantuar se është sipas specifikacionit teknik por e ka cek se duhet të jetë. Gjithashtu kur shikohet dollapi i hapur i OE të rekomanduar për kontratë vërehet se nuk është i njëjtë me dollapin siç është kërkuar në dosje të tenderit sepse është kërkuar që në pjesën e sipërme të jetë fillimisht një raft dhe më poshtë pjesa varëse e rrobave, kurse OE i rekomanduar për kontratë e ka të kundërtën, fillimisht pjesën varëses së rrobave kurse raftin e ka poshtë. OE i rekomanduar për kontratë për të gjitha produktet e ka shënuar se duhet të jetë , e në asnjë rast nuk ka garantuar dhe nuk ka pohuar se produkti është siç e ka kërkuar autoriteti kontraktues, prandaj ky OE duhet të shpallet i pa përgjegjshëm.

Në Aneksin 1 të FDT-së është kërkuar Dollap për dhomën e fëmijëve si në vijim:

Dollap për dhomen e fëmijëve:
Me një gardërobë në mes, me rafte dhe dy sirtarë,
Pasqyra në qendër të dollapit
Gjerësia: 160 cm
Thellësia: 52 cm
Lartësia: 205 cm

Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar artikullin Dollap për dhomën e fëmijëve si në vijim:

Dollap për dhomën e fëmijëve:
Me një gardërobë në mes, me rafte dhe dy sirtarë,

Pasqyra në qendër dollapit:

Gjersia 160 cm
Thellësia 52 cm
Lartësia 205 cm

Konstrukti I ormanit duhet të jetë nga iverpllaka 18mm me dy ndarje, njëra pjesë duhet të jetë me një raft dhe një varëse për garderobë, ndërsa pjesa tjetër duhet të jetë me 4 ndarje. Në pjesën e fundme të ormanit duhet të vendosen dy sirtarë, nga nje për secilen ndarje. Garancioni një vjeqar.

Nga dëshmia e ofruar nga OE propozuar për kontratë kuptohet që artikulli Dollap për dhomën e fëmijëve, nuk është ofruar sipas kërkesës së FDT-së, nga pjesa e jashtme duket të jetë i njëjtë me atë të cilin e ka kërkuar AK-ja, mirëpo nëse shikohet dollapi nga pjesa e brendshme nuk është siç e ka kërkuar AK-ja, gjithashtu dy fotografi për të njëjtin produkt por që janë shumë të ndryshe njëri me tjetrin, andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 7

OE ankues thotë se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm për faktin se nuk i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht kërkesën mbi mundësit teknike dhe ose profesionale

(kërkesa 8). OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar këtë kërkesë për faktin se i njëjti ka prezantuar në ofertë një listë të kontratave me kompani private, mirëpo të cilat nuk mund të vërtetohen me anë të transaksioneve bankare. Nëse analizohen transaksionet bankare të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë në asnjërin prej transaksioneve nuk figuron ndonjë pagesë nga kompanitë me të cilat ka prezantuar kontrata, mirëpo figurojnë disa transfere, e të cilat nuk dihen dhe nuk mund të vërtetohet fakti se për çfarë pagesa bëhet fjalë. Pra në ato transaksione është dashur të figuroj se është bërë pagesa sipas kontratës dhe jo vetëm transaksioni bankar. Gjithashtu referencat e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, përkatësisht tek referenca me kompaninë "Anita-S Sh.p.k". Nëse analizohet teksti i kësaj reference së lëshuar nga "Anita-S Sh.p.k", ku shkruan duke mos pasur asnjëherë vonesa të porosive të ndryshme nga ana jonë karshi biznesit në fjalë, kuptohet që furnizim ka bërë kompania "Anita-S Sh.p.k" e jo OE i rekomanduar për kontratë Mobileria "AGROKOS" Sh.p.k prandaj kjo referencë nuk është valide. Po ashtu kjo referencë nuk duhet të merret parasysh për faktin se në këtë referencë shkruan vetëm se kanë bashkëpunuar dhe askund nuk shkruan se ka bërë furnizime OE "MOBILERIA AGROKOS' Sh.p.k. Gjithashtu në këtë referencë nuk shkruan fare vlera fare e furnizimeve. Po ashtu edhe në kontratë në lidhje me këtë bashkëpunim nuk shkruan askund çmimi e i cili duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës, prandaj nga këto fakte kuptohet se edhe kontrata edhe referenca nuk përkojnë me legjislacionin në fuqi dhe nuk plotësojnë kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të mobileve apo të ngjashme gjatë 3 (tri) viteve të shkuara (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë)".
Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "
Operatori Ekonomik duhet të ofroj një listë të kontratave të realizuara dhe të i dëshmoj me referenca.
Vërejtje:Kontrata/referencat private duhet të dëshmohen me transaksion bankar.

Për plotësimin e kësaj kërkese të DT-së, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar listën e kontratave si në vijim.

Për : Ministria per Komunitete dhe Kthim

Titulli : Furnizim me mobile per te kthyerit dhe komunitetet ne nevoje

Nr.prokurimit : MKK-211/22/001/111

Lista e kontratave

Nr.	Titulli i kontrates	Viti	Bleresi
1.	Furnizim/prodhim te mobiljeve te ndryshme	2021	Nica Swiss Group Shpk
2.	Furnizim/prodhim te mobiljeve te ndryshme	2020	Besimi Commece Shpk
3.	Furnizim/prodhim te mobiljeve te ndryshme	2019	Anita – S Shpk
4.	Furnizim me mobile dhe interior	2019/2021	GNTC Group Sh.A (Gorenje Niti Tiki Company)
5.			

Mobileria Agrokos Shpk

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur një transaksion bankar apo qarkullim bankar, si dhe disa marrëveshje bashkëpunimi-referencë me disa operator ekonomik privat. Ndërsa sa i përket pretendimit për vërtetimin e këtyre kontratave, eksperti shqyrtues sqaron se në dëshminë e transaksionit bankar ka shuma nga operator ekonomik mirëpo nuk ka përshkrim se për çfarë pagese janë bërë ato transfere, dhe në dokumentet e ofruara në E prokurim nuk është gjendur ndonjë dokument që AK-ja i ka verifikuar apo ka kërkuar t'i verifikoj këto transfere, dhe se për cilat kontrata është bërë pagesa.

Po ashtu në referencën e lëshuar nga OE " Anita Sh.p.k" flitet për një bashkëpunim në fushën e prodhimit të mobileve dhe flet për marrëdhëniet e punës, dhe si shenjë bashkëpunimi të ndërsjellët e lëshon këtë referencë OE "Anita sh.p.k". Gjithashtu në këtë referencë nuk është theksuar çmimi, shuma e referencës. Andaj nga kjo që shihet në referencë, kuptohet që referenca është e mangën për nga arsyet që i shtjelluam dhe AK-ja është dashur që mos ta marrë si të mirëqenë.

Ndërsa sa i përket pretendimit të OE ankues se transferi për kompaninë "Anita sh.p.k", se nuk është e qartë se për çka u pagua dhe nuk është valide referenca, eksperti shqyrtues sqaron se në qarkullimin bankar shkruan se : "*TEB-ANITA S SHPK.ANITA S SHPK Pagese për fat nr. 19-SHV01-001- 164*", andaj vlerësojmë se ka një mos harmonizim në mes të referencës dhe transaksionit për faktin se në referencë nuk është e theksuar asnjë shumë ndërsa në transaksion është i specifikuar nr. i faturës.

Gjithashtu edhe kontrata e bashkëpunimit me OE "Besimi Comeerce" fletë për një bashkëpunim në fushën e mobileve që nga data 20.05.2020, po ashtu në qarkullimin bankar është një pagesë e faturës me dt. 20.05.2020, si dhe në të njëjtën datë është edhe kontrata e bashkëpunimit në mes këtyre dy OE.
Po ashtu është lëshuar edhe një referencë nga OE "Nica sëiss Group Sh.p.k", dhe transfer bankar për OE "Nica sëiss Group Sh.p.k ".
Andaj nga sqarimi i dhënë më lartë eksperti shqyrtues sqaron se dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë si referencat dhe kontratat e punës janë të ngjashme njëra me tjetrën, nuk janë pasqyruar elementet si shuma, çmimi dhe nuk është gjendur ndonjë dëshmi që AK-ja i ka kërkuar sqarime dhe ka provuar ti verifikoj, ndaj dhe nuk do të duhej t' merrte si të mirëqena për faktin se nuk kanë një harmonizim mes kontratave, referencave dhe transaksionet e realizuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 8

OE ankues thotë se edhe kontratat tjera dhe referencat tjera janë të një formati dhe pothuajse me tekst identik, e që për neve këto kontrata dhe referenca janë plotësisht në kundërshtim me kërkesat e FDT-së dhe dyshojmë shumë se janë fiktive. Të gjitha kontratat tjera, me përjashtim të kontratës me "GNTC Group SH.A" janë kontrata bashkëpunimi dhe nuk e përmbajnë elementin kyç të kontratës çmimin, prandaj nuk i plotësojnë kushtet për të qenë kontrata sipas ligjit për marrëdhëniet detyrimeve dhe faktikisht janë të pa vlefshme..
Në lidhje me kontratën e lidhur ndërmjet anëtarit të konzerciumit "Limani Sh.p.k me GNTC Group SH.A" ka kundërthënie të mëdha ndërmjet kontratës, referencës dhe transaksioneve bankare. Në kontratë titulli i kontratës është " Furnizim me mobile dhe interier dhe kryerja e punëve që janë të nevojshme për departament stores" me vlerë të kontratës prej 150.000.00 euro e lidhur me dt. 18.03.2018 ndërsa në referencë e ka titullin " Furnizim me rafte dhe dollapë për ekspozitë, të gjitha sipas porosisë" dhe shkruan se " Limani Sh.p.k" ka qenë bashkëpunëtorë gjatë viteve 2019, 2020, 2021. Në këtë rast kuptohet që kontrata dhe referenca mund të jetë fiktive, ndërsa referenca është lëshuar për tre vitet e fundit kuptohet me qëllim që të përfshijnë qarkullimin dhe kryerjen e punëve gjatë tre viteve të fundit për t'u plotësuar kërkesat e FDT-së.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se në kontratën e lidhur në mes të anëtarit të konzerciumit të OE të rekomanduar për kontratë "Limani sh.p.k" dhe OE "GNTC GROUP", objekt i kësaj kontrate në marrëveshjen mes tyre është : "Furnizim me mobilje dhe interier dhe kryerja e punëve që janë të

nevojshme për departament store të kompanisë GNTC GROUP", ndërsa në referencën e lëshuar nga "GNTC GROUP" titulli është " Furnizim me rafta dhe dollapa për ekspozitë, të gjitha sipas porosisë", pra emërtimi nuk është i njëjtë dhe në referencë, si dhe citohet se kanë bashkëpunuar në vitet 2019, 2020, 2021.
Gjithashtu vlerat e transaksioneve bankare nuk përputhen me vlerën e kontratës së nënshkruar në mes këtyre dy palëve.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 9
OE ankues thekson se ne pajtohemi me arsyet e eliminimit për OE "ËOOD CORPORATION LLC" pasi që i njëjti është i pa përgjegjshëm ashtu siç i konstatuar vetë AK-ja.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se OE "ËOOD CORPORATION LLC" ka paraqitur ankesë në OSHP dhe pretendimet ankimore do të shtjellohen dhe do te jepet mëndi i i ekspertit shqyrtues konform shkresave të lëndës lidhur me arsyen e eliminimit të tij.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "WOOD CORPORATION L.L.C" Suharekë
Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues thekson se arsyeja e eliminimit tonë në njoftimin mbi vendimin e AK-së nuk qëndron.
Lidhur me katalogun në rastin konkret nuk ka qenë e ndaluar që ne si Operator Ekonomik të mos i përdorim fotografit e dosjes së tenderit, përkundrazi në këtë mënyrë ne kemi theksuar se marrim përsipër në mënyrë identike të prodhojmë produktet e kërkuara nga ana jonë 100% sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Se ky katalog është në rregull e dëshmonë më së miri fakti i krahasimit të katalogut tonë me OE " Graniti Sh.p.k" i cili ka ofruar një katalog krejt në kundërshtim me dosjen e tenderit dhe pa asnjë specifikë, dhe komisioni vlerësues ka konstatuar se oferta ishte e përgjegjshme. Edhe pse kjo ofertë nuk është shpallur fitues sepse nuk kishte çmimin më të lirë. AK-ja në mënyrë diskriminuese ka bërë vlerësimin tonë në këtë aktivitet të prokurimit. Të gjitha informacionet e nevojshme AK-ja i ka cekur në Njoftimin e vendimit të AK-së do të mund të kishte kërkuar informacione sqaruese të tenderit siç rregullohet me nenin 72 të LPP-së dhe nenin 39 të RRUOPP. Mos kërkimi i sqarimeve e dëshmon se AK-ja nuk ishte e pa anshme apo profesionale në vlerësimin e ofertave dhe në këtë mënyrë ka diskriminuar ofertën tonë më të lirë ku përveç dëmtimit të operatorit ankues ka dëmtuar edhe buxhetin publik.

Eksperti shqyrtues pasi ka analizuar dokumentet e ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit thekson se arsyeja e eliminimit të OE ankues "ËOOD CORPORATION LLC" është se ju keni ofruar katalogun të njëjtë me fotografit të prezantuara nga autoriteti kontraktues dhe ju është dashur të ofroni katalogun konform specifikimeve teknike të kërkuara nga AK-ja në aneksin 1 të FDT-së duke paraqitur modelet tuaja konform atyre specifikave. Gjithashtu OE ankues është eliminuar edhe për disa artikuj të tjerë të katalogut të cilët nuk i ka ofruar konform specifikimeve teknike të kërkuara.

Lidhur me pretendimin se OE "Graniti sh.p.k" ka ofruar katalogun krejt në kundërshtim me dosjen e tenderit dhe pa asnjë specifikë, eksperti shqyrtues sqaron se OE " Graniti sh.p.k" në ofertën e tij ka bashkangjitur katalogun me spicifikacionet e artikujve të kërkuara sipas aneksit 1 të FDT-së, së bashku me fotografit të cilat janë të prezantuara modele të ndryshme.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues thotë se oferta e OE të rekomanduar për kontratë ka shumë mangësi dhe si e tillë është dashur të vlerësohej si e pa përgjegjshme. Në këtë ofertë katalogu i OE nuk ka asnjë përshkrim, fotografi dhe fare nuk e përfshinë kolltukun apo produktin nr.1 sipas DT-së. AK-ja pretendon se këto mungesa janë rregulluar me kërkesa për sqarime, por kjo nëse është e vërtet do të përbënte shkelje materiale të rregullave të prokurimit publik pasi që oferta do të plotësohej pas dorëzimit me të dhëna të cilat nuk janë të verifikueshme dhe në kundërshtim me RRUOPP. Meqë oferta dhe katalogu i OE të rekomanduar për kontratë fare nuk përmban këtë artikull e njëjta ofertë është në sh përputhje materiale me kërkesat e DT-së dhe si e tillë nuk mund të shpërblehet me kontratë.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë ka munguar produkti nr. 1. AK-ja i ka kërkuar sqarime OE të rekomanduar për kontratë dhe OE i është përgjigjur duke dorzuar produktin apo artikullin 1, dhe këtë veprim AK-ja e ka bërë konform nenit 69 të LPP-së si dhe duke u mbështetur në nenin 39 të RRUOPP-së.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues thotë se po ashtu shumë produkte të OE të rekomanduar për kontratë nuk janë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe sa i përket karakteristikave teknike të produktit dhe atyre funksionale.

Referencat dhe kontratat e OE të rekomanduar për kontratë nuk përmbajnë fatura dhe si të tilla nuk mund të dëshmohen se janë zbatuar në përputhje me atë çfarë deklarohen në kontratë apo referencë. AK-ja i ka falur besimin me sy mbyllur për deri sa nuk ka kërkuar asnjë sqarim sa janë zbatuar këto kontrata dhe për ti krahasuar të njëjtat me transaksionet bankare bazuar në faturat e lëshuara.

Për këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me produktet OE ankues nuk ka ngritur pretendim konkret, mirëpo eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigje në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të OE " Graniti " sh.p.k në këtë raport të ekspertizës. Ndërsa lidhur me referencat dhe kontratat e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë është i qëndrueshëm pretendimi i OE ankues, po ashtu edhe për kontrata dhe referenca janë dhënë përgjigje në pretendimet e OE "Graniti" sh.p.k në këtë raport të ekspertizës.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Graniti" sh.p.k Suharekë të aprovohet si e bazuar dhe ankesa e OE "WOOD CORPORATION L.L.C" Suharekë - të aprovohet si pjesërisht e bazuara, dhe rekomandon që aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - Ministria për Komunitete dhe Kthim

Panelit Shqyrtues - OSHP

OE ankues - OE "Graniti" sh.p.k Suharekë dhe OE "WOOD CORPORATION L.L.C" Suharekë